


Performanca e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në luftën kundër korrupsionit gjatë vitit 2021

ANALIZË STATISTIKORE



Performanca e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në Luftën kundër korrupsionit gjatë vitit 2021

ANALIZË STATISTIKORE

Titulli: **Performanca e Sistemit Prokurorial dhe Gjyqësor në Luftën Kundër Korrupsionit gjatë vitit 2021 (analizë statistikore)**

Autore: **Albana Hasani**

Redaktoi: **Nora Bajrami**

Viti i botimit: **Mars 2022**

Publikuar nga: **Lëvizja FOL**

Andrea Gropa nr.35 Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org +383 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2022. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky projekt mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan, përmes Byrosë Ndërkombëtare për Çështje të Narkotikëve dhe Sundim të Ligjit (INL).

*Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Lëvizjes FOL dhe nuk i pasqyron pikëpamjet e Departamentit të Shtetit Amerikan.

Përmbajtja

| | |
|--|-----------|
| 1. Hyrje | 6 |
| 2. Metodologjia | 8 |
| 3. Përmbledhja ekzekutive | 9 |
| 4. Performanca e sistemit prokurorial në trajtimin e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 | 11 |
| 4.1 Fluksi i lëndëve | 16 |
| 4.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate) | 19 |
| 4.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio) | 22 |
| 4.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time) | 25 |
| 4.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara..... | 28 |
| 4.6 Numri i aktakuzave të ngritura (për persona) nga secila prokurori themelore dhe nga ajo speciale | 31 |
| 5. Performanca e sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 | 33 |
| 5.1 Fluksi i lëndëve | 38 |
| 5.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate) | 40 |
| 5.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio) | 42 |
| 5.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time) | 45 |
| 5.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara | 48 |
| 5.6 Mënyra e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit nga gjykatat e republikës së Kosovës | 51 |
| 6. Përfundim | 55 |
| 7. Rekomandime | 57 |
| 8. Shtojca | 58 |

1. Hyrje

Perceptimi shoqëror për nivelin e lartë të pranisë së korrupsionit vazhdon të mbetet një ndër sfidat kryesore me të cilat përballet aparati shtetëror në përgjithësi dhe shoqëria kosovare në veçanti. Studimet e fundit mbi korrupsionin në vend tregojnë se në shoqërinë kosovare vazhdon të ekzistoj një perceptim i lartë mbi praninë e korrupsionit në institucione publike. Bazuar në këto hulumtime, metodat dhe lufta ndaj uljes së nivelit të korrupsionit doemos duhet të jenë sistematike dhe mirë e planifikuara, duke shtuar këtu harmonizimin e legjislacionit tonë kombëtar me praktikën e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Nevoja për luftimin e korrupsionit si fenomen negativ, përveç që është domosdoshmëri, paralelisht reflekton edhe dëshirën për zhvillim dhe funksionim efikas të institucioneve shtetërore.

Prokuroria si organ bartës i hetuesisë dhe gjykata si titullar i ndarjes së drejtësisë, kanë për obligim që t'i dalin ballë detyrës së tyre në drejtim të luftimit të korrupsionit. Kësisoj, qytetaria aktive dhe një sistem i drejtësisë me predispozita për veprim efikas janë garanci për kallëzimin dhe zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit. Luftimi dhe parandalimi i kësaj dukurie negative bëhet ndërmjet bashkëveprimit institucional, të bazuar në respektimin e plotë të standardeve ligjore. Sinergjia e formuar nëpërmjet veprimit të organeve të sistemit të drejtësisë, është hapi i parë i rëndësishëm dhe thelbësor drejt luftimit të korrupsionit.

Dihet se ndjekja e kryerësve të veprave penale bie në barrë të Prokurorit të Shtetit si institucion i pavarur, me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar, të rregulluar me ligj. Ky 'tagër' i sistemit prokurorial natyrisht bëhet më i rëndë, duke marrë parasysh nivelin e përhapjes së korrupsionit, fakt që përmendet edhe në konstatimet e prezantuara në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2021. Aty thuhet se gjatë vitit gjegjës është arritur progres i kufizuar, përfshirë hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të nivelit të lartë, në konfiskimin e pasurive si dhe përmes krijimit të departamenteve speciale që trajtojnë rastet në lidhje me korrupsionin e nivelit të lartë (dhe krimin e organizuar) në gjykata.¹ Prandaj, duke i marrë parasysh këto rrethana faktike mund të themi lirshëm se funksionimi sistemor i prokurorisë, i ndërtuar mbi standardet më të larta profesionale dhe në respektimin e normave të trasuara nga ana e organeve kryesore të Bashkimit Evropian, janë pikësynimi mbi të cilën do të duhej të punonte i gjithë sistemi prokurorial në Republikën e Kosovës.


¹ [European Commission - Kosovo Report, 2021.](#)

Ndërsa sistemi gjyqësor përbën hallkën, e cila bën ndarjen e drejtësisë. Gjykatat e të gjitha niveleve të Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh gjendjen e korrupsionit të cilën e kanë përballë, duhet që në mënyrë efikase të përballen me rastet e korrupsionit. Rezultati i mirë i punës së gjykatave është indikator real i seriozitetit shtetëror në luftën ndaj korrupsionit. Prandaj, efikasiteti i gjyqësorit në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit në afat të arsyeshëm dhe në mënyrë profesionale nënkupton uljen dhe parandalimin serioz të veprave penale të korrupsionit.

Sfidë tjetër brenda sistemit të drejtësisë, pra sistemit gjyqësor dhe prokurorial, na paraqitet edhe matja e kualitetit, funksionalitetit, efikasitetit, transparencës, nivelit të respektimit të standardeve organizative etj.. Analizimi i parametrave të përcaktuara shërben që të vlerësohet gjendja e kualitetit dhe efektivitetit të drejtësisë. Duke i analizuar dhe vlerësuar parametrat e tillë shenjësohen mangësitë e veprimit sistematik të organeve të drejtësisë dhe vendosen standardet gjithëpërfshirëse të forcimit të kualitetit të drejtësisë.

Duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, të dhënat e vetme me të cilat mund të analizojmë performancën e gjykatave dhe prokurorive, janë të dhënat statistikore zyrtare të ofruara nga vet gjykatat dhe prokuroritë. Konstruktimi i rezultatit të të dhënave mbi performancën e kualitetit dhe efektivitetit të gjykatave dhe prokurorive të Republikës së Kosovës në këtë raport synohet të bëhet duke e përdorur metodologjinë e *Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ)*.

Pra, përmes të dhënave zyrtare të pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke i gërshetuar me formulat e CEPEJ-it, do të mund të vlerësojmë punën e gjykatave dhe prokurorive mbi lëndët e korrupsionit në mënyrë specifike. Vlerësimi i tillë, në bazë të të dhënave mbi lëndët nga rastet e korrupsionit, do të na mundësojë që të kemi parasysh fluksin e lëndëve me të cilin përballen gjykatat dhe prokuroritë gjatë një viti kalendarik, normën e arritur të zgjidhjes së lëndëve, vlerësimin e normës së qarkullimit të lëndëve, trendin e nivelizimit të lëndëve, kohëzgjatjen procedurale të trajtimit të lëndëve dhe indeksin e lëndëve të grumbulluara.



2. Metodologjia

Ky raport adreson çështjen e performancës dhe efikasitet të sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit, si dhe shtjellon nivelin e ngarkesës së punës së këtyre institucioneve në zgjidhjen e këtyre lëndëve. Raporti është bazuar në të dhënat statistikore zyrtare të pranuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) për vitin 2021, ndërsa për matjen e performancës së këtyre institucioneve mbi bazën e këtyre statistikave zyrtare, FOL ka përdorur metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).²

Të gjitha statistikat e paraqitura në këtë raport përfshijnë vetëm një grup të veçantë të veprave penale, më saktësisht *Kapitullin XXXIII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, që titullohet **“Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”** dhe përfshinë nenet 414-430. Këto statistika përfshijnë vetëm veprat penale me kryerës të njohur (PP).

Efikasiteti i Prokurorisë Speciale dhe shtatë prokurorive themelore (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjiilan, Ferizaj, Gjakovë), në njërën anë, dhe e shtatë gjykatave themelore të Kosovës, në anën tjetër, kanë qenë pjesë e matjes së performancës dhe e monitorimit në këtë raport. Kjo matje nuk përfshinë cilësinë e lëndëve, cilësinë e punës së prokurorive dhe gjykatave, cilësinë e shërbimit të administratës apo integritetin dhe profesionalizmin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, por vetëm analizën numerike (sasiore) të tyre.

Fushat në të cilat FOL është bazuar për matjen e performancës së prokurorisë dhe gjyqësorit janë si në vazhdim: 1) *fluksi i lëndëve*, 2) *norma e zgjidhjes së lëndëve*, 3) *norma e qarkullimit të lëndëve*, 4) *kohëzgjatja e trajtimit të lëndëve*, si dhe 5) *indeksi i lëndëve të grumbulluara*.

Në pjesën e parë të raportit është matur performanca e sistemit prokurorial në trajtimin/zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit, përmes indikatorëve të Komisionit Evropian të Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) në nivel të përgjithshëm dhe për secilën prokurori veç e veç. Ndërsa në pjesën tjetër është analizuar performanca e sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit përmes metodologjisë së CEPEJ, po ashtu në nivel të përgjithshëm dhe për secilën gjykatë veç e veç, si dhe numri dhe lloji i vendimeve të shqiptuara nga ana e gjykatave. Matje të tillë nga statistikat e prokurorisë përmes metodologjisë së CEPEJ, FOL ka bërë edhe në të kaluarën³, dhe të njëjtën do ta vazhdojë në mënyrë periodike edhe në muajt e ardhshëm.

² Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) është organi i Këshillit të Evropës, i cili përpaket të përmirësuar efikasitetin dhe funksionimin e drejtësisë në shtetet anëtare dhe të zhvillojë dhe zbatojë instrumentet praktike të miratuara nga Këshilli i Evropës për këtë qëllim. Duhet theksuar se raporti i Lëvizjes FOL nuk është i autorizuar nga Këshilli i Evropës dhe se formulat, edhe pse janë identike, nuk janë zyrtare.

³ Për më tepër, shih: *Performanca e Prokurorisë në Luftën Kundër Korrupsionit 2017*; *Performanca e Prokurorisë në Zgjidhjen e Lëndëve të Korrupsionit gjatë vitit 2020*.

3. Përmbledhja ekzekutive

Matja e performancës së organeve të drejtësisë është një aktivitet i domosdoshëm në analizimin e ndërveprimit sistemor dhe funksional, ku përmes të dhënave të paraqitura identifikohen faktorët konkret të funksionimit apo mosfunksionimit strukturor dhe organizues të sistemit të drejtësisë.

Me performancë të prokurorive dhe gjykatave nënkuptojmë rezultatet e arritura gjatë procesit të kryerjes së veprimeve dhe detyrave. Matja e performancës së cilësisë në thelb natyrisht nuk nënkupton vetëm marrjen e shifrave statistikore, mirëpo ajo ka për qëllim vlerësimin objektiv të punës së prokurorive dhe gjykatave në Republikën e Kosovës. Cilësia dhe efektiviteti i sistemit të drejtësisë duhet të jenë gjithmonë nën "llupën" e vëzhgimit të nivelit të tyre. Lidhur me këtë, vetëm përmes një metodologjie të analizës dhe vlerësimit të vazhdueshëm të sistemit të drejtësisë mund të gjenden mangësitë që pashmangshëm duhen përmirësuar.

Në bazë të të dhënave që i kemi siguruar dhe projektimit të tyre në bazë të metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), në këtë përmbledhje do të përshkruajmë disa nga gjetjet kryesore të këtij raporti.


- Nga 802 lëndë të korrupsionit sa kanë qenë në punë në shtatë prokuroritë themelore dhe në atë speciale (317 prej të cilave të trashëguara nga viti paraprak dhe 485 lëndë të reja), kanë arritur të zgjidhen gjithsej 409 lëndë, përkatësisht 51 % e të gjitha lëndëve në punë. Ndërkaq pjesa prej 393 lëndëve kanë mbetur të pazgjidhura dhe janë bartur për vitin 2022.
Ndërsa gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2021 gjithsej në punë i kanë pasur 383 lëndë të korrupsionit (281 prej të cilave kanë qenë të trashëguara nga viti paraprak dhe 102 lëndë të reja), kanë arritur të zgjidhin 108 lëndë, apo 28 % të të gjitha lëndëve që i kanë pasur në punë.
- Sfiduese vazhdon të mbetet bartja e numrit të madh të lëndëve nga viti në vit. Në vitin 2021, në prokuroritë themelore të Republikës së Kosovës dhe në atë speciale ishin bartur gjithsej 317 lëndë të korrupsionit nga viti paraprak, apo 40% e lëndëve në punë.
Ndërsa në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës në vitin 2021 ishin bartur 281 lëndë nga viti paraprak, përkatësisht 73 % e lëndëve që kanë qenë në punë.
- Norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në të gjitha prokuroritë e Republikës së Kosovës për vitin 2021 rezulton të jetë 84 %, që nënkupton së numri i lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe ishte më i ulët se numri i lëndëve të reja të pranuar gjatë vitit. Ndërsa norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në të gjitha gjykatat themelore gjatë vitit 2021 ishte 106%, që nënkupton se numri i lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (108 lëndë) e tejkalon numrin e lëndëve të reja (102 lëndë) të krijuara gjatë vitit.
- Norma e qarkullimit të lëndëve gjatë kësaj periudhe ishte 1.04, që është krijuar mbi faktin se numri i lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe ishte më i madh në raport me lëndët që kanë mbetur të pazgjidhura. Ndërsa norma e qarkullimit të lëndëve në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2021 është arritur 0.39, meqë sistemi gjyqësor ka arritur të zgjidh vetëm 108 lëndë, përkatësisht vetëm 28 % të të gjitha lëndëve që i ka pasur në punë, ndërsa 275 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura dhe janë bartur për vitin 2022.

- Indeksi i lëndëve të grumbulluara në Prokurorin e Shtetit gjatë vitit 2021 është arritur në 0.77 dhe ka rrjedhur si pasojë e faktit se numri i lëndëve të korrupsionit të trashëguara (të bartura) nga viti paraprak është më i ulët në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë këtij viti. Ndërsa indeksi i lëndëve të grumbulluara në gjykatat themelore Kosovës është dukshëm më i lartë, përkatësisht 2.60, për shkak se numri i lëndëve të trashëguara nga viti paraprak ishte dukshëm më i madh, se numri i lëndëve të zgjidhura gjatë këtij viti.
- Me fluksin më të madh të lëndëve të korrupsionit gjatë kësaj periudhe është përballur Prokuroria Themelore e Prishtinës, e cila në punë ka pasur 245 lëndë. Ndërkaq prokuroria me fluksin më të ulët të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 ka qenë Prokuroria Themelore e Gjilanit, e cila në punë ka pasur gjithsej 54 lëndë të korrupsionit. Ndërsa sa i përket lëndëve të korrupsionit në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës, me fluksin më të madh të lëndëve është përballur Gjykata Themelore e Prishtinës, me 197 lëndë në punë, ndërsa me fluksin më të ulët të këtyre lëndëve është përballur Gjykata Themelore e Gjakovës, me gjithsej 15 lëndë në punë.
- Sipas statistikave të Këshillit Prokurorial të Kosovës, prokuroria që ka arritur rezultatet më të mira në trajtimin e rasteve të korrupsionit gjatë kësaj periudhe është Prokuroria Themelore e Prizrenit, e cila gjatë kësaj periudhe ka arritur normën më të lartë të zgjidhjes së lëndëve (120 %), normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve (4.29 %) si dhe kohën më të shkurtë të nevojshme për zgjidhjen e lëndëve që këtë vit kishin ngelur të pazgjidhura (85 ditë). Me fjalë të tjera, nga 90 lëndë të korrupsionit sa ka pasur në punë, kjo prokurori ka arritur të zgjidh 73 prej tyre, apo 81 %.
Ndërsa sipas të dhënave të pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, rezultatet më të mira në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë kësaj periudhe i ka arritur Gjykata Themelore e Prizrenit, e cila gjatë kësaj periudhe e ka arritur normën më të lartë të qarkullimit të Lëndëve (1.15), indeksin më të ulët të lëndëve të grumbulluara (1.13), si dhe kohën më të shkurtër të nevojshme për zgjidhjen e lëndëve që këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura (317 ditë). Me fjalë të tjera, nga 43 lëndë të korrupsionit sa ka pasur në punë kjo gjykatë, ka arritur të zgjidh 23 lëndë, apo 53% të të gjitha lëndëve.
- Ndërkaq prokuroria me rezultatet më të dobëta në trajtimin e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 (njëjtë sikurse në vitin 2020) ishte *Prokuroria Themelore e Mitrovicës*, e cila nga 133 lëndë sa ka pasur në punë gjatë këtij viti, ka arritur të trajtoj vetëm 28 prej tyre, apo vetëm 13 % të të gjitha lëndëve. Kjo prokurori gjatë kësaj periudhe ka arritur normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve (0.26), normën më të ulët të zgjidhjes së lëndëve (44%) si dhe indeksin më të lartë të lëndëve të grumbulluara (2.96).
Ndërsa gjykata me rezultatet më të dobëta në trajtimin e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 është *Gjykata Themelore e Prishtinës*, e cila nga 197 lëndë sa ka pasur në punë, ka arritur të zgjidh vetëm 34 prej tyre, apo vetëm 17 %. Kjo gjykatë gjatë kësaj periudhe e ka arritur normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve (0.20), indeksin më të lartë të grumbullimit të lëndëve (4.61), si dhe kohën më të gjatë për zgjidhjen e lëndëve që këtë vit kishin ngelur të pazgjidhura.
- Sipas të dhënave të pranuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, shtatë prokuroritë themelore dhe Prokuroria Speciale gjatë vitit 2021 kishin ngritur aktakuza ndaj 335 personave në lidhje me veprat penale të korrupsionit.
- Ndërkaq sipas të dhënave të pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nga 108 lëndët e korrupsionit të zgjidhura nga shkalla e parë e gjyqësorit gjatë këtij viti, janë sjellë 59 aktgjykime fajësuese, 26 aktgjykime liruese, 4 aktgjykime refuzuese, si dhe 19 lëndë janë zgjidhur në mënyrë tjetër. Nga aktgjykimet fajësuese, për pjesën më të madhe të tyre, përkatësisht për 31 lëndë, janë shqiptuar dënime më gjobë, ndërsa për 22 lëndë janë shqiptuar dënime me burg dhe për 6 lëndë dënime me kusht.

----- Performanca
e sistemit
prokurorial
në trajtimin
e lëndëve të
korrupsionit gjatë
vitit 2021



Duke i analizuar përparësitë
dhe shpërfaqur dobësitë
në punën e prokurorive
gjatë trajtimit të lëndëve të
korrupsionit, do të mund të
kontribuojmë në pasqyrimin
e situatës së përgjithshme të
luftës ndaj korrupsionit.



4. Performanca e sistemit prokurorial në trajtimin e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021

Rezultati nga përllogaritja e performancës së prokurorive të Republikës së Kosovës në trajtimin e lëndëve të korrupsionit është një tregues mbi seriozitetin, vullnetin dhe vendosmërinë e sistemit prokurorial në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Duke i analizuar përparësitë dhe shpërfaqur dobësitë në punën e prokurorive gjatë trajtimit të lëndëve të korrupsionit, do të mund të kontribuojmë në pasqyrimin e situatës së përgjithshme të luftës ndaj korrupsionit. Performanca e mirë e prokurorive në trajtimin e lëndëve të korrupsionit, pra efikasiteti në ndjekjen e personave të involvuar në këto vepra penale, nënkupton respektimin e plotë të ligjeve dhe prioritetëve të vendosura nga ana e Këshillit Prokurorial.

Në vijim janë paraqitur indikatorët matës të efikasitetit të punës së Prokurorit të Shtetit (Prokurorisë Speciale dhe shtatë prokurorive themelore) në përgjithësi në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit në vitin 2021. Ndërsa pasqyra e përgjithshme me të dhënat e sistemit prokurorial, në të cilët janë bazuar këta indikatorë, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

















































| | PS Lëndë të trashëguara | I Lëndë të reja | LP Gjithsej lëndë në punë | R Lëndë të zgjidhura | PE Lëndë të pazgjidhura |
|---|---|--|--|---|--|
|  Prokuroria Speciale | 44  | 69  | 113  | 53  | 60  |
|  Prokuroria Themelore e Prishtinës | 106  | 139  | 245  | 128  | 117  |
|  Prokuroria Themelore e Prizrenit | 29  | 61  | 90  | 73  | 17  |
|  Prokuroria Themelore e Pejës | 21  | 35  | 56  | 31  | 25  |
|  Prokuroria Themelore e Gjiçanit | 8  | 46  | 54  | 40  | 14  |
|  Prokuroria Themelore e Mitrovicës | 83  | 50  | 133  | 28  | 105  |
|  Prokuroria Themelore në Ferizaj | 14  | 42  | 56  | 37  | 19  |
|  Prokuroria Themelore në Gjakovë | 12  | 43  | 55  | 19  | 36  |
| TOTAL: | 317 | 485 | 802 | 409 | 393 |

TABELA 1. Pasqyra e përgjithshme e performancës së sistemit prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021.

4.1 Fluksi i lëndëve

Pjesë e rëndësishme e rrethit të vështirësive për menaxhimin sa më efikas dhe cilësor të lëndëve nga ana e prokurorive është fluksi i madh i lëndëve. Fluksi i lëndëve është tregues bazë i ngarkesës në punë dhe përfshin lëndët e reja, lëndët e zgjidhura dhe lëndët në pritje të zgjidhjes.

Numri i lëndëve të reja nënkupton numrin e lëndëve që futen në sistem dhe që kërkojnë veprim nga prokurorët, ndërsa numri i lëndëve të zgjidhura është përgjigjja që jep sistemi prokurorial, pra numri i lëndëve që janë trajtuar.⁴ Ndërkaq lëndët që priten të trajtohen janë numri i lëndëve që mbeten për t'u zgjidhur nga prokuroria në një kohë të caktuar dhe si të tilla janë lëndë që barten në vitin e ardhshëm. Në analizë nuk është përfshirë faza fillestare, pra faza e hetimit apo e mbledhjes së informatave para se ato të kthehen në kallëzime penale. Në raport pra janë përfshirë vetëm kallëzimet penale të dërguara në prokurori dhe adresimi i tyre nga ana e sistemit prokurorial.

Fluksi i lëndëve përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) shprehet përmes kësaj formule:

$$LP \text{ (lëndë në punë)} = PS \text{ (lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese)} + I \text{ (lëndë të reja)}$$

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2021, gjithsej raste në punë në *Prokurorinë Speciale* dhe në shtatë prokuroritë themelore në lidhje me veprat penale të *Kapitullit XXXIII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare)* kanë qenë 802 lëndë.

Në këtë numër, pra, kanë kontribuar lëndët e bartura nga viti paraprak (317 lëndë), si dhe lëndët e reja të krijuara gjatë vitit (485 lëndë). Pra, shprehur në përqindje, mesatarisht 40 % e lëndëve të korrupsionit në punë të të gjitha prokurorive ishin të bartura nga viti paraprak, ndërsa 60 % e lëndëve ishin lëndë të reja, të krijuar gjatë vitit 2021.

Kjo shifër tregon se numri i lëndëve në punë gjatë vitit 2021 në të gjitha prokuroritë themelore dhe në atë speciale, ka qenë dukshëm më i lartë se në vitin 2020, ku në punë gjatë këtij viti ishin gjithsej 646 lëndë.⁵

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur fluksi i lëndëve të shtatë prokurorive themelore veç e veç dhe të Prokurorisë Speciale gjatë vitit 2021.

⁴ Trajtimi dhe zgjidhja mund të shërbejnë si fjalë që zëvendësojnë njëra-tjetrën. Për gjykata përdoret fjala "zgjidh" kurse për prokurori "trajtohen". Kjo pasi lënda në prokurori nuk konsiderohet e zgjidhur pa një vendim të gjykatës.

⁵ Për më tepër, shih: Performanca e Prokurorisë në Luftën Kundër Korrupsionit, Lëvizja FOL, prill 2020.

LP (lëndë në punë) = PS (lëndë të trashëguara) + I (lëndë të reja)



Prokuroria Speciale



113

= 44 + 69



Prokuroria Themelore
e Prishtinës



245

= 106 + 139



Prokuroria Themelore
e Prizrenit



90

= 29 + 61



Prokuroria Themelore
e Pejës



56

= 21 + 35



Prokuroria Themelore
e Gjiçanit



54

= 8 + 46



Prokuroria Themelore
e Mitrovicës



133

= 83 + 50



Prokuroria Themelore
në Ferizaj



56

= 14 + 42



Prokuroria Themelore
në Gjakovë



55

= 12 + 43

TOTAL:



802

= 317 + 485

TABELA 2.

Fluksi i lëndëve të korrupsionit në Prokurorinë Speciale dhe në shtatë prokuroritë themelore gjatë vitit 2021.

Sipas tabelës së paraqitur më lartë, rezulton se me fluksin më të lartë të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 është përballur:

● **Prokuroria Themelore e Prishtinës**, e cila gjatë kësaj periudhe në punë kishte 245 lëndë, 106 prej të cilave ishin të trashëguara nga viti paraprak, ndërsa 128 janë krijuar gjatë vitit 2021. Kjo është prokuroria me numrin më të madh të lëndëve të reja të korrupsionit të krijuara gjatë vitit 2021, si dhe me numrin më të madh të lëndëve të bartura nga viti paraprak.

Ndërsa me fluksin më të ulët të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 është përballur:

● **Prokuroria Themelore e Gjilanit**, e cila në punë kishte gjithsej 54 lëndë, 8 prej të cilave ishin të trashëguara nga viti paraprak, ndërsa 46 lëndë ishin krijuar të reja. Kjo prokurori dallohet me numrin më të ulët të lëndëve të reja, të krijuara gjatë vitit 2021, si dhe me numrin më të vogël të lëndëve të bartura nga viti paraprak.

Edhe sipas matjes së performancës së Sistemit Prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit për vitin 2020⁶, me fluksin më të madh të lëndëve ishte përballur Prokuroria Themelore në Prishtinë (me gjithsej 221 lëndë në punë), përkatësisht 24 lëndë më pak se në vitin 2021.

Ndërsa prokuroria me fluksin më të ulët të lëndëve të korrupsionit në vitin 2020 ishte Prokuroria Themelore e Gjakovës, me gjithsej 27 lëndë në punë, apo 27 lëndë më pak se në vitin 2021.

6 Për më tepër, shih: [Performanca e Prokurorisë në Luftën Kundër Korrupsionit gjatë vitit 2020, Lëvizja FOL](#).

4.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate)

Norma e zgjidhjes së lëndëve është një indikator i rëndësishëm që mat raportin midis numrit të lëndëve të reja (I) dhe numrit të lëndëve të zgjidhura (R). Pra në kuadër të matjes, në këtë indikator nuk përfshihen numri i lëndëve të trashëguara nga viti paraprak. Si i tillë, ky indikator tregon performancën e një prokurorie të shprehur në përqindje, si dhe tregon për kapacitetin punues të prokurorive në zgjidhjen e lëndëve të reja. Norma ideale e zgjidhjes së lëndëve do të duhej të ishte 100 %, që nënkupton se sistemi zgjidh aq lëndë sa pranon gjatë vitit.

Norma e zgjidhjes së lëndëve sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{Lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{Lëndët e reja (I)}} \times 100$$

Rrjedhimisht sipas kësaj formule, norma mesatare e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 në të gjitha prokuroritë themelore dhe në atë speciale është si vijon:

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{409}{485} \times 100 = 84 \%$$

Pra sipas kësaj formule, numri i lëndëve të korrupsionit të zgjidhura gjatë vitit 2021 ishte 409, numri i lëndëve të reja të pranuar gjatë vitit 2021 ishte 485, norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 del të jetë 84 %. Pra numri i lëndëve të reja të pranuar gjatë vitit 2021 ishte ndjeshëm më i lartë në raport me lëndët e zgjidhura gjatë këtij viti, që nënkupton mungesë të kapaciteteve për zgjidhjen e lëndëve të reja dhe krijon ngarkesë në të ardhmen me çështje paraprake.

Me fjalë të tjera, nga 802 lëndë të korrupsionit që ishin në punë gjatë vitit 2021 (këtu përfshihen lëndët e trashëguara nga vitet paraprake dhe lëndët e reja të krijuara gjatë vitit), prokuroritë kanë arritur të zgjedhin 409 lëndë, përkatësisht 51% të lëndëve, ndërsa pjesa tjetër prej 393 lëndësh kanë mbetur të pazgjidhura dhe janë bartur për vitin 2022.

Kjo nënkupton se në raport me vitin 2020, kur norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në prokuroritë e Republikës së Kosovës kishte rezultuar të jetë 87 %, ky indikator në vitin 2021 kishte pësuar rënie në 84%.

Ndërkaq norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në secilën prokurori themelore dhe në atë speciale gjatë vitit 2021 është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{Lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{Lëndët e reja (I)}} \times 100$$



Prokuroria Speciale



$$\frac{53}{69} \times 100 = 77\%$$



Prokuroria Themelore e Prishtinës



$$\frac{128}{139} \times 100 = 92\%$$



Prokuroria Themelore e Prizrenit



$$\frac{73}{61} \times 100 = 120\%$$



Prokuroria Themelore e Pejës



$$\frac{31}{35} \times 100 = 89\%$$



Prokuroria Themelore e Gjilanit



$$\frac{40}{46} \times 100 = 87\%$$



Prokuroria Themelore e Mitrovicës



$$\frac{28}{50} \times 100 = 56\%$$



Prokuroria Themelore në Ferizaj



$$\frac{37}{42} \times 100 = 88\%$$



Prokuroria Themelore në Gjakovë



$$\frac{19}{43} \times 100 = 44\%$$

TOTAL:



$$\frac{409}{485} \times 100 = 84\%$$

TABELA 3.

Norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 në shtatë prokuroritë themelore dhe në atë speciale.

Sipas tabelës së paraqitur më lartë, rezulton se normën më të lartë të zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 e ka arritur:

- **Prokuroria Themelore e Prizrenit**, e cila kishte 61 lëndë të reja të krijuara gjatë vitit, ndërsa kishte arritur të zgjidh 73 lëndë, duke arritur normën e zgjidhjes së lëndëve në 120%;

Ndërsa normën më të ulët të zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit e ka arritur:

- **Prokuroria Themelore e Gjakovës**, e cila kishte 43 lëndë të reja të krijuara gjatë vitit, ndërsa kishte arritur të zgjidh 19 lëndë, duke arritur normën e zgjidhjes së lëndëve në 44%.

Ndërkaq sipas matjes së performancës së sistemit prokurorial në luftën kundër korrupsionit të bërë për vitin 2020⁷, normën më të lartë të zgjidhjes së lëndëve gjatë këtij viti e kishte arritur Prokuroria Themelore e Ferizajt (103%), e cila nga 29 lëndë të reja të krijuara gjatë vitit, kishte arritur të zgjidh 30 lëndë, ndërsa normën më të ulët të zgjidhjes së lëndëve e kishte arritur Prokuroria Themelore e Pejës (0.52), e cila nga 36 lëndë të reja të krijuara gjatë vitit, kishte arritur të zgjidh vetëm 19 lëndë.

⁷ Për më tepër, shih: [Performanca e Prokurorisë në Luftën Kundër Korrupsionit gjatë vitit 2020, Lëvizja FOL](#).

4.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio)

Norma e qarkullimit të lëndëve mat raportin mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrit të lëndëve të pazgjidhura brenda një viti. Pra kjo normë e mat frekuencën me të cilën sistemi e zëvendëson numrin e lëndëve të reja. Formula e Komisionit Evropian për Matjen e Efikasitetit të Drejtësisë përdor numrin e lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese dhe e pjesëton me numrin e lëndëve të pazgjidhura, duke nxjerrë normën e qarkullimit të lëndëve.

Me falë të tjera, norma qarkullimit të lëndëve mat se sa shpejt sistemi (në këtë rast i prokurorisë) i trajton lëndët që i pranon—që ndryshe i bie se sa shumë kohë merr sistemi për zgjidhjen e një lënde.

Norma e qarkullimit të lëndëve përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Matjen e Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{Lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{Lëndët e pa zgjidhura (PE)}}$$

Rrjedhimisht nga kjo formulë, norma mesatare e qarkullimit të lëndëve në të gjitha prokuroritë themelore dhe atë speciale gjatë vitit 2021 është:

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{409}{485} = 1.04$$

Norma ideale e qarkullimit të lëndëve do të duhej të ishte të paktën 1, që nënkupton se sistemi zgjidh po aq lëndë sa pranon gjatë vitit dhe nuk ka bartur asnjë lëndë për vitin e ardhshëm. Ndërsa, në këtë rast norma e qarkullimit të lëndëve është pak më e madhe se 1, që nënkupton se në rastin konkret ka diferencë të vogël në raport me normën ideale të qarkullimit të lëndëve.

Norma e qarkullimit të lëndëve nuk ka pësuar ndryshim të madh në raport me vitin e kaluar (vitin 2020), ku kjo normë kishte rezultuar në 1.03.⁸

Norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 në secilën prokurori themelore dhe në atë speciale është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

⁸ <https://levizjafol.org/ep-content/uploads/2021/04/Performanca-E-Prokuroris%C3%AB-N%C3%AB-Luft%C3%ABn-Kund%C3%ABr-Korrupsionit.pdf>.

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{Lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{Lëndët e pa zgjidhura (PE)}}$$



Prokuroria Speciale

$$\frac{53}{60} = \mathbf{0.88} \quad \text{↔}$$

Prokuroria Themelore e
Prishtinës

$$\frac{128}{117} = \mathbf{1.09} \quad \text{↔}$$

Prokuroria Themelore e
Prizrenit

$$\frac{73}{17} = \mathbf{4.29} \quad \text{↔}$$

Prokuroria Themelore e
Pejë

$$\frac{31}{25} = \mathbf{1.24} \quad \text{↔}$$

Prokuroria Themelore e
Gjilanit

$$\frac{40}{14} = \mathbf{2.85} \quad \text{↔}$$

Prokuroria Themelore e
Mitrovicës

$$\frac{28}{105} = \mathbf{0.26} \quad \text{↔}$$

Prokuroria Themelore në
Ferizaj

$$\frac{37}{19} = \mathbf{1.94} \quad \text{↔}$$

Prokuroria Themelore në
Gjakovë

$$\frac{19}{36} = \mathbf{0.52} \quad \text{↔}$$

TOTAL:

$$\frac{409}{393} = \mathbf{1.04} \quad \text{↔}$$

TABELA 4.

Norma e qarkullimit të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 në shtatë prokuroritë themelore dhe në atë speciale.

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën më lartë, rezulton se normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve të korrupsionit në vitin 2021 e ka arritur.

● **Prokuroria Themelore e Prizrenit**, e cila kishte arritur normën e qarkullimit të lëndëve në 4.29.

Kjo prokurori kishte arritur të zgjidh 73 lëndë, përkatësisht 81% të lëndëve që i kishte në punë, ndërsa vetëm 17 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura, të cilat janë bartur në vitin 2022.

Ndërsa normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve e ka arritur:

● **Prokuroria Themelore e Mitrovicës**, e cila kishte arritur normën e qarkullimit të lëndëve në

0.26. Kjo prokurori kishte arritur të zgjidh vetëm 28 lëndë, përkatësisht 21% të lëndëve që i kishte në punë, ndërsa 108 lëndë kishin mbetur të pazgjidhura, të cilat janë bartur në vitin 2022.

Në raport me vitin 2020, sipas matjes së bërë për performancën e sistemit prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë këtij viti, normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve gjatë këtij viti e ka arritur Prokuroria Themelore e Gjilanit (4.12), e cila kishte zgjidhur 33 lëndë, ndërsa vetëm 8 i kishte bartur për vitin 2021. Ndërsa normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve edhe në vitin 2020 e kishte arritur Prokuroria Themelore e Mitrovicës (0.2), e cila kishte arritur të zgjidh vetëm 17 lëndë, ndërsa 83 i ka bartur për vitin 2021.

4.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time)

Komisioni Evropian i Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) kërkon që sistemi i drejtësisë të raportoj një indikatorë të kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve, që kalkullohet në dy hapa.

Së pari, numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese pjesëtohet me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese, që njihet si normë e qarkullimit të lëndëve.⁹

Së dyti, kjo normë e qarkullimit të lëndës pjesëtohet me 365, kështu që indikator i kohëzgjatjes së zgjidhjes së lëndëve mund të shprehet me numrin e ditëve, për të cilin CEPEJ sugjeron se e thjeshtëzon kuptimin e marrëdhënies mes numrit të lëndëve të zgjedhura gjatë periudhës raportuese dhe numrit të lëndëve që priten të zgjidhen (lëndët e bartura).¹⁰

Bazuar në normën e qarkullimit të lëndëve, kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) formulohet në këtë mënyrë:

$$\text{Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{\text{norma e qarkullimit të lëndëve}}$$

Pra numri 365 është numri i ditëve brenda një viti, i cili pjesëtohet me normën e qarkullimit të lëndëve të shtatë prokurorive themelore dhe të asaj speciale. Siç është përshkruar edhe në faqen 22 të këtij raporti, ky numër ka rrjedhur si rezultat i pjesëtimit të numrit të lëndëve të zgjidhura (409) me numrin e lëndëve të pazgjidhura (393).

Komisioni Evropian i Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) kërkon që sistemi i drejtësisë të raportoj një indikatorë të kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve të cilat kishin mbetur të pazgjidhura gjatë kësaj periudhe.

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve që kishin mbetur të pazgjidhura gjatë vitit 2021 në secilën prokurori themelore dhe në atë speciale veç e veç është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

⁹ https://www.courtexcellence.com/__data/assets/pdf_file/0030/54795/GLOBAL-MEASURES-3rd-Edition-Oct-2020.pdf .

¹⁰ Po aty.

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve = $\frac{365}{\text{norma e qarkullimit të lëndëve}}$



Prokuroria Speciale

$$\frac{365}{0.88} = 414$$



Prokuroria Themelore e Prishtinës

$$\frac{365}{1.09} = 334$$



Prokuroria Themelore e Prizrenit

$$\frac{365}{4.29} = 85$$



Prokuroria Themelore e Pejës

$$\frac{365}{1.24} = 294$$



Prokuroria Themelore e Gjiçanit

$$\frac{365}{2.85} = 128$$



Prokuroria Themelore e Mitrovicës

$$\frac{365}{0.26} = 1,403$$



Prokuroria Themelore në Ferizaj

$$\frac{365}{1.94} = 188$$



Prokuroria Themelore në Gjakovë

$$\frac{365}{0.52} = 701$$



TABELA 5.

Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve që nuk janë zgjidhur gjatë vitit 2021 në shtatë prokuroritë themelore dhe në atë speciale.

Sipas tabelës së paraqitur më lartë, rezulton se koha më e shkurtë për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit që në këtë vit kishin ngelur të pazgjidhura i duhet:

- **Prokurorisë Themelore e Prizrenit**, të cilës i duhen mesatarisht edhe 85 ditë për zgjidhjen e të gjitha lëndëve të korrupsionit që në këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura. Kjo për shkak se, siç u shtjelluar edhe në faqen 23 të këtij raporti, kjo prokurori kishte arritur normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve gjatë kësaj periudhe të monitorimit (4.29).

Ndërsa kohë më e gjatë për zgjidhjen e këtyre lëndëve i duhet:

- **Prokurorisë Themelore e Mitrovicës** të cilës i duhen mesatarisht edhe 1,403 ditë për zgjidhjen e të gjitha lëndëve të korrupsionit që në këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura. Kjo ka ardhur si rezultati i normës së ulët të qarkullimit të lëndëve që e kishte arritur kjo prokurori gjatë kësaj periudhe të monitorimit (0.26).

Ndërkaq sa i përket matjes së këtij indikatori të bërë për vitin 2020¹¹, kohë më e shkurtë për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit që në këtë vit kishin ngelur të pazgjidhura i është dashur Prokurorisë Themelore të Gjilanit (88 ditë), ndërsa kohë më e gjatë për zgjidhjen e këtyre lëndëve edhe gjatë vitit 2020 i është dashur Prokurorisë Themelore të Mitrovicës (1,825 ditë).

11 Performanca e Prokurorisë në Luftën Kundër Korrupsionit gjatë vitit 2020, Lëvizja FOL.

4.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Një prej problemeve kryesore që raportohet në sistemin e drejtësisë në Kosovë është numri i madh i lëndëve të grumbulluara ndër vite. Prokuroritë, ashtu sikurse gjykatat, vazhdojnë të përballen me lëndë të vjetra që bëhen barrë e ngarkesë e rëndë, e që barten vit pas viti.

Zgjatja e trajtimit të lëndëve dhe numri i madh i lëndëve të bartura bën që të rritet mosbesimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë, pasi ata duhet të presin me vite të tëra që sistemi të merret me lëndët e tyre dhe të ndaj drejtësi për to.

Pra indikator kyç i performancës së prokurorive është edhe indeksi i lëndëve të grumbulluara. Ky indikator determinohet nga numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, në pjesëtim me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara, përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}$$

Rrjedhimisht sipas kësaj formule, indeksi i lëndëve të grumbulluara të shtatë prokurorive themelore dhe të asaj speciale është :

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{317}{409} = 0.77$$

Vlera më e lartë se 0 e indeksit të lëndëve të grumbulluara tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e një lënde. Përkatësisht, nëse në këtë rast do të zgjidheshin 317 lëndë, nënkupton se sistemi ka zgjidhur aq lëndë sa ka trashëguar, dhe si e tillë vlera do të ishte 0. Ndërsa në rastin konkret nënkuptohet se prokuroria ka zgjidhur më shumë lëndë se sa ka trashëguar nga viti paraprak.

Ndërkaq në raport me vitin e kaluar (vitin 2020), numri i lëndëve të grumbulluara ka pësuar një ulje të ndjeshme, meqenëse gjatë vitit 2020 indeksi i lëndëve të grumbulluara ishte 0.81.¹²

Indeksi i lëndëve të grumbulluara në secilën prokurori themelore dhe në atë speciale, është shprehur në tabelën e mëposhtme:

¹² Performanca e Sistemit Prokurorial në Zgjidhjen e Lëndëve të Korrupsionit, faqe 12.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara = $\frac{\text{Lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{Lëndët e zgjidhura (R)}}$



Prokuroria Speciale

$$\frac{44}{53}$$

= **0.83**



Prokuroria Themelore
e Prishtinës

$$\frac{106}{128}$$

= **0.82**



Prokuroria Themelore
e Prizrenit

$$\frac{29}{73}$$

= **0.39**



Prokuroria Themelore
e Pejës

$$\frac{21}{31}$$

= **0.67**



Prokuroria Themelore
e Gjilanit

$$\frac{8}{40}$$

= **0.20**



Prokuroria Themelore
e Mitrovicës

$$\frac{83}{28}$$

= **2.96**



Prokuroria Themelore
në Ferizaj

$$\frac{14}{37}$$

= **0.37**



Prokuroria Themelore
në Gjakovë

$$\frac{12}{19}$$

= **0.63**



TOTAL: $\frac{317}{409}$

= **0.77**



TABELA 6. Indeksi i lëndëve të grumbulluara gjatë vitit 2021 në shtatë prokuroritë themelore dhe në atë speciale.

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën më lartë, rezulton se indeksin më të ulët të lëndëve të grumbulluara e ka arritur:

● **Prokuroria Themelore e Gjilanit**, me indeks të lëndëve të grumbulluara në 0.20. Kjo për shkak se, nga 8 lëndë të trashëguara nga viti paraprak dhe 46 lëndë të krijuara gjatë vitit 2021, kjo prokurori kishte arritur të zgjidh 40 prej tyre.

Ndërsa indeksin më të lartë të lëndëve të grumbulluara e ka arritur:

● **Prokuroria Themelore e Mitrovicës**, me indeks të lëndëve të grumbulluara në 2.96. Kjo për shkak se, nga 83 lëndë të trashëguara nga viti paraprak dhe 133 lëndë të krijuara gjatë vitit 2021, kjo prokurori kishte arritur të zgjidh vetëm 28 prej tyre, ndërsa pjesën tjetër prej 105 lëndësh i ka bartur për vitin 2022.

Ndërkaq sipas matjes së bërë për vitin 2020, gjatë këtij viti indeksin më të ulët të lëndëve të grumbulluara e kishte Prokuroria Themelore e Pejës dhe e Prokuroria Themelore e Gjilanit (0.2), ndërsa me indeksin më të lartë të lëndëve të grumbulluara edhe gjatë vitit 2020 e kishte arritur Prokuroria Themelore e Mitrovicës (4.47).

4.6 Numri i aktakuzave të ngritura (për persona) nga secila prokurori themelore dhe nga ajo speciale

Gjatë korrespondencës zyrtare me Zyrën për Komunikim me Publikun të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ku kemi kërkuar numrin e aktakuzave të ngritura gjatë periudhës 1 vjeçare, ata na kanë ofruar të dhëna vetëm për numrin e personave të përfshirë në këto aktakuza, por jo edhe numrin e aktakuzave të ngritura.

FOL ka tentuar disa herë të marrë përgjigje në lidhje me këto të dhëna (pra për numrin e aktakuzave, si të dhëna bazike të sistemit prokurorial), mirëpo përgjigjja ishte e njëjtë, pra se sistemi prokurorial mënyrën e zgjidhjes së rasteve e pasqyron vetëm përmes personave, dhe jo sipas numrit të lëndëve.¹³

Në këtë mënyrë, FOL ka mundur të sigurojë vetëm numrin e aktakuzave për persona të ngritura nga secila prokurori themelore dhe ajo speciale gjatë vitit 2021, por jo edhe numrin e aktakuzave si lëndë.

Rrjedhimisht, sipas të dhënave të pranuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, shtatë prokuroritë themelore dhe Prokuroria Speciale gjatë vitit 2021 kanë ngritur aktakuza për gjithsej 335 persona të përfshirë në lidhje me veprat penale të Kapitullit XXXIII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përkatësisht të korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare.

Numri më i madh i personave të ndjekur penalisht për veprat penale të korrupsionit ishin nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, përkatësisht 95 persona, duke u pasuar nga Prokuroria Themelore e Ferizajt, me 47 persona.

Numri i aktakuzave të ngritura në lidhje me veprat penale të korrupsionit (për persona) nga secila prokurori themelore dhe ajo speciale gjatë vitit 2021, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

¹³ Në përgjigjen zyrtare të personave përgjegjës të Zyrës së Statistikave të KPK-së, të dërguar me 1 mars 2022, ndër të tjera thuhet: "... Zyra për statistika grumbullon dhe pasqyron të dhënat për mënyrën e zgjidhjes së rasteve, sipas personave, se nuk ka logjikë ndryshe. Në rastin konkret prokurori ka ngritur aktakuza ndaj personave të cilët janë implikuar në këto vepra penale. Zyra për Statistika përherë të dhënat për mënyrën e zgjidhjes së rasteve i pasqyron përmes personave".

| | | Aktakuza të drejtpërdrejta | Aktakuza pas zhvillimit të hetimeve |
|---|-----------------------------------|---|--|
|  | Prokuroria Speciale | 0 | 43  |
|  | Prokuroria Themelore e Prishtinës | 3  | 92  |
|  | Prokuroria Themelore e Prizrenit | 0 | 44  |
|  | Prokuroria Themelore e Pejës | 10  | 11  |
|  | Prokuroria Themelore e Gjiçanit | 7  | 27  |
|  | Prokuroria Themelore e Mitrovicës | 5  | 28  |
|  | Prokuroria Themelore në Ferizaj | 5  | 42  |
|  | Prokuroria Themelore në Gjakovë | 1  | 17  |
| TOTAL | | 31 persona | 304 persona |


TABELA 7.

Numri i aktakuzave për persona të ngritura gjatë vitit 2021 në shtatë prokuroritë themelore dhe në atë speciale.

----- Performanca e
sistemit gjyqësor
në zgjidhjen
e lëndëve të
korrupsionit gjatë
vitit 2021



Puna dhe vendosmëria e gjykatave të Republikës së Kosovës në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit mund të vërehet në të dhënat periodike të cilat përmbajnë të dhëna sistematike që nga pranimi i rasteve dhe deri te zgjidhja përfundimtare e tyre.



5. Performanca e sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021

Puna dhe vendosmëria e gjykatave të Republikës së Kosovës në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit mund të vërehet në të dhënat periodike të cilat përmbajnë të dhëna sistematike që nga pranimi i rasteve dhe deri te zgjidhja përfundimtare e tyre. Këto të dhëna duhet të përpunohen në pajtim me metodologjinë adekuate, në mënyrë që të krijojmë pasqyrën e madhe të përmbushjes së misionit të sistemit gjyqësor mbi këtë fushë specifike. Rezultati i dalur nga një përpunim i tillë do të jetë tregues i qartë i normës së zgjidhjes së lëndëve dhe indikatorëve të tjerë në fushën e korrupsionit.

Në vijim janë paraqitur rezultatet nga indikatorët matës të efikasitetit të punës së Gjykatave të Republikës së Kosovës në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021, sipas metodologjisë së *Komisionit Evropian për Matjen e Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ)*.

Ndërsa pasqyra e përgjithshme me të dhënat e sistemit gjyqësor të vitit 2021, në të cilët janë bazuar këta indikatorë, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.










































| | PS Lëndë të trashëguara | I Lëndë të reja | LP Gjithsej lëndë në punë | R Lëndë të zgjidhura | PE Lëndë të pazgjidhura |
|--|---|---|---|---|---|
|  Gjykata Themelore në Prishtinë | 157  | 40  | 197  | 34  | 163  |
|  Gjykata Themelore në Gjiilan | 18  | 9  | 27  | 14  | 13  |
|  Gjykata Themelore në Prizren | 26  | 17  | 43  | 23  | 20  |
|  Gjykata Themelore në Mitrovicë | 40  | 14  | 54  | 11  | 43  |
|  Gjykata Themelore në Gjakovë | 10  | 5  | 15  | 7  | 8  |
|  Gjykata Themelore në Pejë | 10  | 7  | 17  | 6  | 11  |
|  Gjykata Themelore në Ferizaj | 20  | 10  | 30  | 13  | 17  |
| | TOTAL: 281 | 102 | 383 | 108 | 275 |

TABELA 8. Pasqyra e përgjithshme e performancës së sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021.

5.1 Fluksi i lëndëve

Siç është shtjelluar edhe në pjesën e parë të këtij raporti, fluksi i lëndëve është tregues i ngarkesës së sistemit me lëndë në punë dhe përfshin lëndët e reja të krijuara gjatë vitit dhe lëndët e trashëguara, respektivisht të bartura nga viti paraprak.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur fluksi i lëndëve të korrupsionit në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës.

LP (lëndë në punë) = PS (lëndë të trashëguara) + I (lëndë të reja)



TABELA 9. Fluksi i lëndëve të korrupsionit në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2021.

Nga kjo tabelë shihet se gjykatat themelore të Republikës së Kosovës kanë pasur në punë gjithsej 383 lëndë të korrupsionit. Në krijimin e këtyre lëndëve kanë kontribuar lëndët e trashëguara nga viti 2020, përkatësisht 281 lëndë, si dhe numri i lëndëve të krijuara gjatë vitit 2021, përkatësisht 102 lëndë.

Pra, shprehur në përqindje, mesatarisht 73 % e lëndëve të korrupsionit në punë të të gjitha gjykatave ishin të bartura nga viti paraprak, ndërsa 27 % e lëndëve ishin lëndë të reja të krijuar gjatë vitit 2021.

Nga tabela e vendosur më sipër, shihet se me fluksin më të madh të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 ishte përballur:

- **Gjykata Themelore e Prishtinës**, e cila në punë kishte gjithsej 197 lëndë të korrupsionit, 157 prej të cilave ishin trashëguar nga viti paraprak, ndërsa 40 lëndë ishin krijuar gjatë vitit 2021.

Ndërsa me fluksin më të ulët të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 ishte përballur:

- **Gjykata Themelore e Gjakovës**, e cila në punë kishte gjithsej 15 lëndë të korrupsionit, 10 prej të cilave ishin trashëguar nga viti paraprak, ndërsa 5 lëndë ishin krijuar gjatë vitit 2021.

5.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate)

Siç është theksuar edhe në pjesën e parë të këtij raporti, norma e zgjidhjes së lëndëve është një indikator i rëndësishëm që tregon performancën e gjykatave në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit të shprehur në përqindje, si dhe tregon për kapacitetin punues të gjykatave. Në këtë normë nuk përfshihen numri i lëndëve të trashëguara, por vetëm numri i lëndëve të reja, të krijuara gjatë vitit.

Ashtu siç u shpjegua në pjesën e parë, norma e zgjidhjes së lëndëve sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{Lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{Lëndët e reja (I)}} \times 100$$

Rrjedhimisht sipas kësaj formule, norma mesatare e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në vitin 2021 në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës ishte:

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{108}{102} \times 100 = 106 \%$$

Sipas kësaj formule, ku numri i lëndëve të korrupsionit të zgjidhura gjatë vitit 2021 ishte 108 lëndë, ndërsa numri i lëndëve të reja të krijuara gjatë vitit ishte 102 lëndë, norma e lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2021 ishte 106%. Pra shkalla e parë e sistemit gjyqësor në vitin 2021 ka arritur të zgjidh 6 lëndë më shumë se sa ka pranuar në vitin 2021, prandaj kjo është reflektuar edhe në normën e lartë të zgjidhjes së lëndëve.

Ndërsa, nëse merret parasysh edhe numri i madh i lëndëve të bartura nga viti 2020, përkatësisht 281 lëndë, që bashkërisht me lëndët e reja përfshijnë 383 lëndë në punë, kjo nënkupton se shkalla e parë e sistemit gjyqësor ka arritur të zgjidh vetëm 28% të lëndëve të korrupsionit që i ka pasur në punë gjatë vitit 2021.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në secilën prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

Nga kjo tabelë, shihet se normën më të lartë të zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në vitin 2021 e ka arritur:

- **Gjykata Themelore e Gjilanit**, e cila kishte 9 lëndë të reja të krijuara gjatë vitit 2021, ndërsa kishte arritur ti zgjidh 14 lëndë, duke arritur normën e zgjidhjes së lëndëve në 156 %;

Ndërsa normën më të ulët të zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit e kishte arritur:

- **Gjykata Themelore e Mitrovicës**, e cila kishte 14 lëndë të reja të krijuara gjatë vitit 2021, ndërsa kishte arritur të zgjidh 11 lëndë, duke arritur normën e zgjidhjes së lëndëve në 79 %.

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e reja (I)}} \times 100$$



Gjykata Themelore në
Prishtinë

$$\frac{34}{40} \times 100 = 82\%$$



Gjykata Themelore në
Gjilan

$$\frac{14}{9} \times 100 = 86\%$$



Gjykata Themelore në
Prizren

$$\frac{23}{17} \times 100 = 140\%$$



Gjykata Themelore në
Mitrovicë

$$\frac{11}{14} \times 100 = 79\%$$



Gjykata Themelore në
Gjakovë

$$\frac{7}{5} \times 100 = 140\%$$



Gjykata Themelore në
Pejë

$$\frac{6}{7} \times 100 = 86\%$$



Gjykata Themelore në
Ferizaj

$$\frac{13}{10} \times 100 = 130\%$$



TOTAL:

$$\frac{108}{102} \times 100 = 120\%$$



TABELA 10. Norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2021.

5.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio)

Norma e qarkullimit të lëndëve mat raportin mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrin e lëndëve të pazgjidhura. Pra kjo normë e mat frekuencën me të cilën sistemi gjyqësor e zëvendëson numrin e lëndëve të reja. Me fjalë të tjera, norma qarkullimit të lëndëve mat se sa shpejt sistemi (në këtë rast sistemi gjyqësor) i trajton lëndët që i pranon—që ndryshe i bie se sa shumë kohë merr sistem për zgjidhjen e një lënde.

Norma e qarkullimit të lëndëve përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Matjen e Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{Lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{Lëndët e pazgjidhura (PE)}}$$

Rrjedhimisht sipas kësaj formule, norma mesatare e qarkullimit të lëndëve të korrupsionit në vitin 2021 në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës ishte:

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{108}{275} = 0.39$$

Norma ideale e qarkullimit të lëndëve do të duhej të ishte të paktën 1, që nënkupton se sistemi zgjidh po aq lëndë sa pranon gjatë vitit dhe nuk ka bartur asnjë lëndë për vitin e ardhshëm.

Ndërsa në rastin konkret, sistemi gjyqësor ka arritur të zgjidh vetëm 108 lëndë, përkatësisht vetëm 28 % të të gjitha lëndëve që i ka pasur në punë, ndërsa 275 lëndë, apo 72% nuk kanë arritur t'i zgjidh dhe i ka bartur në vitin 2022, prandaj e ka arritur këtë normë të ulët të qarkullimit të lëndëve.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në secilën prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{Lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e pa zgjidhura (PE)}}$$



Gjykata Themelore
në Prishtinë

$$\frac{34}{163} = \mathbf{0.20}$$




Gjykata Themelore
në Gjilan

$$\frac{14}{13} = \mathbf{1.07}$$




Gjykata Themelore në
Prizren

$$\frac{23}{20} = \mathbf{1.15}$$




Gjykata Themelore në
Mitrovicë

$$\frac{11}{43} = \mathbf{0.25}$$




Gjykata Themelore në
Gjakovë

$$\frac{7}{8} = \mathbf{0.87}$$




Gjykata Themelore
në Pejë

$$\frac{6}{11} = \mathbf{0.54}$$




Gjykata Themelore
në Ferizaj

$$\frac{13}{17} = \mathbf{0.76}$$


$$\text{TOTAL: } \frac{108}{275} = \mathbf{0.39}$$


TABELA 11.

Norma e qarkullimit të lëndëve të korrupsionit në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2021.

Nga kjo tabelë, shihet se normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve të korrupsionit në vitin 2021 e ka arritur:

- **Gjykata Themelore e Prizrenit**, e cila këtë vit kishte arritur normën e qarkullimit të lëndëve në 1.15. Kjo gjykatë kishte arritur të zgjidh 23 lëndë, përkatësisht 53 % të lëndëve që i kishte në punë, ndërsa 20 lëndë (47 %) kanë mbetur të pazgjidhura dhe janë bartur në vitin 2022.

Ndërsa normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve të korrupsionit e ka arritur:

- **Gjykata Themelore e Prishtinës**, e cila këtë vit kishte arritur normën e qarkullimit të lëndëve në 0.20. Kjo gjykatë kishte arritur të zgjidh 34 lëndë, përkatësisht 17 % të lëndëve që i kishte në punë gjatë këtij viti, ndërsa 163 lëndë (83 %) kanë mbetur të pazgjidhura dhe janë bartur në vitin 2022.

5.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time)

Komisioni Evropian i Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) kërkon që sistemi i drejtësisë të raportoj një indikatorë të kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve të cilat kishin mbetur të pazgjidhura gjatë kësaj periudhe.

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) formulohet në këtë mënyrë:

$$\text{Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{\text{norma e qarkullimit të lëndëve}}$$

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në secilën prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

$$\text{Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{\text{norma e qarkullimit të lëndëve}}$$



Gjykata Themelore
në Prishtinë

$$\frac{365}{0.20} = \mathbf{1,825}$$



Gjykata Themelore
në Gjiilan

$$\frac{365}{1.07} = \mathbf{341}$$



Gjykata Themelore
në Prizren

$$\frac{365}{1.15} = \mathbf{317}$$



Gjykata Themelore
në Mitrovicë

$$\frac{365}{0.25} = \mathbf{1,460}$$



Gjykata Themelore në
Gjakovë

$$\frac{365}{0.87} = \mathbf{419}$$



Gjykata Themelore
në Pejë

$$\frac{365}{0.54} = \mathbf{675}$$



Gjykata Themelore në
Ferizaj

$$\frac{365}{0.76} = \mathbf{480}$$



TABELA 12.

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve të korrupsionit në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2021.

Sipas tabelës së paraqitur më lartë, rezulton se koha më e shkurtër për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit që në këtë vit kishin ngelur të pazgjidhura i duhet:

- **Gjykatës Themelore të Prizrenit**, të cilës i duhen mesatarisht edhe 317 ditë për zgjidhjen e të gjitha lëndëve të korrupsionit që në këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura. Kjo për shkak se kjo gjykatë kishte arritur normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve gjatë kësaj periudhe të monitorimit (1.15).

Ndërsa koha më e gjatë për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit i duhet:

- **Gjykatës Themelore të Prishtinës**, të cilës i duhen mesatarisht edhe 1,825 ditë për zgjidhjen e të gjitha lëndëve të korrupsionit që në këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura. Kjo për shkak se kjo gjykatë kishte arritur normën më të shkurtër të qarkullimit të lëndëve gjatë kësaj periudhe të monitorimit (0.20), si dhe numrin më të lartë të lëndëve të grumbulluara, që janë bartur për vitin 2022.

5.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Një prej problemeve kryesore që raportohet në sistemin e drejtësisë në Kosovë është numri i madh i lëndëve të grumbulluara. Këto lëndë barten nga viti në vit, duke krijuar ngarkesë të papërballueshme për sistemin e drejtësisë.

Ky indikator determinohet nga numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, në pjesëtim me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara, përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}$$

Rrjedhimisht sipas kësaj formule, indeksi mesatar i lëndëve të grumbulluara në të gjitha gjykatat themelore gjatë vitit 2021 është:

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{281}{108} = 2.60$$

Vlera më e lartë se rezultati 0 i këtij indikator, nënkupton se sistemit i nevojitet kohë më e gjatë për zgjidhjen e lëndëve. Përkatësisht, nëse në këtë rast do të zgjidheshin 281 lëndë (aq sa ka qenë numri i lëndëve të trashëguara), nënkupton se sistemi ka zgjidhur aq lëndë sa ka trashëguar, dhe si e tillë vlera do të ishte 0. Në rastin konkret, numri i lëndëve të trashëguara nga viti paraprak ishte dukshëm më i lartë se sa numri i lëndëve që ka mundur të zgjidh sistemi gjatë këtij viti, prandaj është reflektuar në indeksin e lartë të lëndëve të grumbulluara.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur indeksi mesatar i lëndëve të korrupsionit të grumbulluara në secilën prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{Lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{Lëndët e zgjidhura (R)}}$$



Gjykata Themelore në
Prishtinë

$$\frac{157}{34}$$

= **4.61**



Gjykata Themelore në
Gjilan

$$\frac{18}{14}$$

= **1.28**



Gjykata Themelore në
Prizren

$$\frac{26}{23}$$

= **1.13**



Gjykata Themelore në
Mitrovicë

$$\frac{40}{11}$$

= **3.63**



Gjykata Themelore në
Gjakovë

$$\frac{10}{7}$$

= **1.42**



Gjykata Themelore
në Pejë

$$\frac{10}{6}$$

= **1.66**



Gjykata Themelore në
Ferizaj

$$\frac{20}{13}$$

= **1.53**



TOTAL

$$\frac{281}{108}$$

= **2.60**



TABELA 13.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2021.

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën më lartë, rezulton se indeksin më të ulët të lëndëve të grumbulluara gjatë vitit 2021 e ka arritur:

- **Gjykata Themelore e Prizrenit**, me indeks të lëndëve të grumbulluara në 1.13. Kjo për shkak se, nga 26 lëndë të trashëguara nga viti paraprak dhe 17 lëndë të krijuara gjatë vitit 2021, kjo gjykatë kishte arritur të zgjidh 23 prej tyre. Ndërkaq vetëm 20 lëndë i ka bartur për vitin 2022.

Ndërsa me indeksin më të lartë të lëndëve të grumbulluara gjatë vitit 2021 e ka arritur:

- **Gjykata Themelore e Prishtinës**, me indeks të lëndëve të grumbulluara në 4.61. Kjo për shkak se, nga 157 lëndë të trashëguara nga viti paraprak dhe 40 lëndë të krijuara gjatë vitit, kjo gjykatë kishte arritur të zgjidh vetëm 34 prej tyre. Kjo gjykatë për vitin 2022 i ka bartur gjithsej 163 lëndë.

5.6 Mënyra e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit nga gjykatat e Republikës së Kosovës

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit nga të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2021, nga 108 lëndët e zgjidhura gjatë këtij viti, janë sjellë 59 aktgjykime fajësuese, 26 aktgjykime liruese, 4 aktgjykime refuzuese, si dhe 19 lëndë janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

Kjo nënkupton se pjesa më e madhe e lëndëve të korrupsionit që kanë qenë në punë në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2021, apo 55 % e tyre, janë zgjidhur me aktgjykime fajësuese.

Ndërsa për pjesën tjetër të lëndëve, apo për 49 prej tyre, janë sjellë aktgjykime liruese (24%), aktgjykime refuzuese (4%), apo janë zgjidhur në ndonjë mënyrë tjetër (18 %).

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur mënyra e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2021 në secilën prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

Mënyra e zgjidhjes së lëndëve











| | | Aktgjykime fajësuese | | | Aktgjykime liruese | Aktgjykime refuzuese | Janë zgjidhur në mënyrë tjetër |
|---|--------------------------------|----------------------|-----------------|-----------------|---|---|---|
| | | Dënime me burgim | Dënime me gjobë | Dënime me kusht |  |  |  |
|  | Gjykata Themelore në Prishtinë | 8 | 5 | 2 | 9 | 1 | 9 |
|  | Gjykata Themelore në Gjiilan | 2 | 5 | 0 | 5 | 0 | 2 |
|  | Gjykata Themelore në Prizren | 7 | 8 | 1 | 7 | 0 | 0 |
|  | Gjykata Themelore në Mitrovicë | 1 | 3 | 1 | 3 | 2 | 1 |
|  | Gjykata Themelore në Gjakovë | 1 | 3 | 2 | 0 | 0 | 1 |
|  | Gjykata Themelore në Pejë | 2 | 3 | 0 | 1 | 0 | 0 |
|  | Gjykata Themelore në Ferizaj | 1 | 4 | 0 | 1 | 1 | 6 |
| | TOTAL | 22 | 31 | 6 | 26 | 4 | 19 |

TABELA 14. Mënyra e zgjidhjes së lëndëve në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2021.

Siç shihet edhe në tabelën e vendosur më sipër, nga aktgjykimet fajësuese, për pjesën më të madhe të tyre, përkatësisht për 31 lëndë, janë shqiptuar dënime me gjobë. Ndërsa për 22 lëndë janë shqiptuar dënime me burg dhe për 6 lëndë dënime me kusht. Numrin më të madh të aktgjykimeve fajësuese gjatë kësaj periudhe i ka shqiptuar Gjykata Themelore e Prizrenit, përkatësisht 16 aktgjykime fajësuese.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë grafike lloji i dënimeve të shqiptuara nga gjykatat themelore të Republikës së Kosovës në lidhje me lëndët e korrupsionit gjatë vitit 2021.



GRAFIKON 1. Llojet e dënimeve të shqiptuar nga të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2021.

6. Përfundim

Rezultatet e vlerësimit të performancës së punës së institucioneve të sistemit të drejtësisë pasqyrojnë vullnetin, profesionalizmin, seriozitetin dhe gatishmërinë që këto institucione kanë në zbatimin e detyrave të tyre kushtetuese dhe ligjore, përmbushjen e qëllimeve të misionit të sistemit të drejtësisë si dhe pritjeve të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Në këtë raport, matja e efikasitetit dhe performancës së punës së institucioneve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, nuk është shtrirë në analiza të koordinatave cilësore të punës profesionale, por vetëm në kuadër të vlerësimit të normave të punëve të kryera në aspekt kuantitativ.

Në këtë aspekt, Institucioni i Prokurorit të Shtetit ka arritur të trajtoj gjysmën e lëndëve që ka pasur në punë gjatë vitit 2021. Përkatësisht, nga 802 lëndë sa ka pasur në punë Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2021, ka arritur të trajtojë 409 lëndë, apo 51% të të gjitha lëndëve të korrupsionit sa kanë pasur në punë gjatë këtij viti.

Situata nuk qëndron numerikisht më ndryshe as në vitin 2020, ku nga 646 lëndë sa kishte në punë Prokurori i Shtetit gjatë këtij viti, kishte arritur të trajtoj 51% të lëndëve, apo 329 lëndë.

Rrjedhimisht, duke pasur parasysh fluksin më të lartë të lëndëve me të cilin Prokurori i Shtetit ishte përballur gjatë vitit 2021, përkatësisht numrin e madh të lëndëve të bartura nga viti 2020 (si rrjedhojë e përhapjes së pandemisë COVID-19), si dhe numrin më të madh të lëndëve të reja të krijuara gjatë vitit, mund të thuhet se në vitin 2021 ishte arritur efikasitet më i lartë i lëndëve të trajtuara se në vitin e kaluar, pavarësisht se shkalla e lëndëve të trajtuara vazhdon të mbetet e njëjtë.

Një prej sfidave kryesore me të cilin sistemi i drejtësisë po përballlet, e në veçanti sistemit prokurorial, është bartja e numri të madh të lëndëve nga viti në vit. Situata e tillë duket se nuk po gjen përmirësim. Kjo për shkak se numri i lëndëve të bartura (trashëguara) nga ana e shtatë prokurorive themelore dhe të asaj speciale për vitin 2022 ka shënuar rritje për 24%, në raport me numrin e lëndëve të trashëguara për vitin 2021. Me fjalë të tjera, në vitin 2021 ishin bartur 317 lëndë nga viti paraprak, ndërsa për vitin 2022 janë bartur 393 lëndë.

Ngarkesën më të madhe me lëndë të korrupsionit gjatë kësaj periudhe e ka pasur Prokuroria Themelore e Prishtinës, e cila në punë ka pasur 245 lëndë, ndërsa ka arritur të trajtoj 128 prej tyre, përkatësisht 52%. Ndërsa shkallën më të lartë të trajtimit të lëndëve e ka arritur Prokuroria Themelore e Prizrenit, e cila ka trajtuar 73 lëndë, nga 90 lëndë sa ka pasur në punë.

Ndërkaq shkalla e parë e sistemi gjyqësor gjatë vitit 2021 ka arritur shkallë të ulët të zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit. Nga 383 lëndët sa kanë pasur në punë gjithsej, shtatë gjykatat themelore gjatë vitit 2021, kishin arritur të zgjidhin vetëm 108 lëndë, apo vetëm 28% të të gjitha lëndëve të korrupsionit.

Si shkaktar kryesor i kësaj shkalë të ulët të zgjidhjes së lëndëve, edhe për sistemin gjyqësor, natyrisht mbetet numri i madh i lëndëve të bartura nga viti 2020, që kanë krijuar ngarkesë të madhe për sistemin gjyqësor.¹⁴

¹⁴ Lëndët e korrupsionit gjatë periudhës mars–qershor të vitit 2020 nuk kanë mundur të merren parasysh, për shkak të përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe punës së sistemit të drejtësisë gjatë kësaj periudhe vetëm me raste të natyrës urgjente. Si rezultat, këto lëndë janë bartur për muajt tjerë, duke krijuar ngarkesë të madhe për sistemin.

Në këtë shkallë të ulët të zgjidhjes së lëndëve nuk duhet lënë anash edhe faktorët e tjerë që mund të paraqiten si shkaktar, duke filluar nga mungesa e kapaciteteve njerëzore, e në veçanti nga numri i vogël i gjyqtarëve.

Ngarkesën më të madhe me lëndë të korrupsionit natyrisht e ka pasur Gjykata Themelore e Prishtinës, me gjithsej 245 lëndë në punë, ndërsa shkallën më të lartë të zgjidhjes së lëndëve në vitin 2021 e ka arritur Gjykata Themelore e Prizrenit, e cila nga 43 lëndë që i ka pasur në punë, ka arritur të zgjidh 23 prej tyre, përkatësisht 52 %.

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes së lëndëve dhe llojeve të dënimeve të shqiptuara, gjatë vitit 2021 shkalla e parë e sistemit gjyqësor kishte sjellë 59 aktgjykime fajësuese, 26 aktgjykime liruese, 4 aktgjykime dënuese, si dhe 19 lëndë janë zgjidhur në mënyra tjera. Nga aktgjykimet fajësuese, për 31 lëndë janë shqiptuar dënime më gjobë, ndërsa për 22 lëndë janë shqiptuar dënime me burg dhe për 6 lëndë dënime me kusht.

7. Rekomandime

Duke marrë parasysh qëllimin e përpilimit të këtij raporti, gjatë rrugës së përpunimit të të dhënave dhe gjetjes së rezultateve në bazë të një metodologjie paraprakisht të përcaktuar, kanë derivuar disa pikëpamje mbi objektin e hulumtimit.

Gjetjet e këtij raporti përveç që paraqesin pasqyrën e punës së prokurorive dhe gjykatave, ato paraqesin tregues të qartë të zhvillimit, përmirësimit dhe ngritjes së efikasitetit. Prandaj, duke bërë ndërlidhjen në mes të konkluzioneve të këtij raporti dhe intencës për ngritje të efikasitetit të punës së Prokurorit të Shtetit dhe të sistemit gjyqësor, Lëvizja FOL jep këto rekomandime:

- Të krijohet një njësit i veçantë në sistemin gjyqësor që merret me rastet e korrupsionit, njësoj sikurse Njësi për Krime Ekonomike dhe Korrupsion në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;
- Lëndët e korrupsionit, e veçanërisht ato të profilit të lartë, të trajtohen me prioritet absolut nga sistemi i drejtësisë;
- Të respektohen në përpikmëri obligimet në trajtimin e rasteve të korrupsionit sipas afateve dhe obligimeve të përcaktuara në ligj;
- Të rritet vazhdimisht transparenca e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në lidhje me ofrimin e qasjes në dokumente publike në pajtim me obligimet që dalin nga ligji;
- Të rritet bashkëpunimi ndër-institucional, si një premisë bazë për suksesin e veprimtarisë së sistemit të drejtësisë në luftimin e suksesshëm të korrupsionit;
- Të publikohen në vazhdimësi raportet statistikore në ueb-faqen zyrtare të sistemit prokurorial dhe të atij gjyqësor në lidhje me numrin e lëndëve të zgjidhura dhe në trajtimin e rasteve të korrupsionit.

Shtojca

Pasqyrë e përgjithshme mbi mënyrën e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në shkallën e parë të sistemit gjyqësor gjatë vitit 2021

| Përshkrimi i llojit të veprave penale | Lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese | Lëndë të pranuar në punë | Gjithsej lëndë në punë | Gjithsej persona të akuzuar | Mënyra e zgjidhjes | | | | | | | | Gjithsej lëndë të zgjidhura | Gjithsej persona ndaj të cilëve ka përfunduar procedura | Lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese | Numri i personave ndaj të cilëve nuk ka përfunduar procedura gjyqësore |
|---|--|--------------------------|------------------------|-----------------------------|-----------------------|----------------|----------------|--------------|---------------------|-----------------------|---------------------------------|------------|-----------------------------|---|--|--|
| | | | | | Me aktgjykim fajësues | | | | Me aktgjykim lirues | Me aktgjykim refuzues | Është zgjidhur në mënyrë tjetër | | | | | |
| | | | | | Dënim me burgim | Dënim me gjobë | Dënim me kusht | Dënime tjera | | | | | | | | |
| KORRUPSIONI ZYRTAR DHE VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE | 281 | 102 | 383 | 983 | 22 | 31 | 6 | 0 | 26 | 4 | 19 | 108 | 165 | 275 | 818 | |
| KEQPËRDORIMI I POZITES APO AUTORITETIT ZYRTAR | 167 | 67 | 234 | 724 | 19 | 18 | 6 | 0 | 18 | 4 | 13 | 78 | 125 | 156 | 599 | |
| KEQPËRDORIMI DHE MASHTRIMI NË PROKURIM PUBLIK | 1 | 7 | 8 | 9 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 4 | 4 | 4 | 5 | |
| KEQPËRDORIMI I INFORMATËS ZYRTARE | 1 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 0 | 0 | |
| KONFLIKTI I INTERESIT | 4 | 1 | 5 | 5 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 3 | 3 | |
| PËRVETËSIMI NË DETYRË | 47 | 2 | 49 | 78 | 0 | 2 | 0 | 0 | 2 | 0 | 3 | 7 | 9 | 42 | 69 | |
| MASHTRIMI NË DETYRË | 2 | 1 | 3 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 6 | |
| PËRDORIMI I PAAUTORIZUAR I PASURISË | 4 | 1 | 5 | 31 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 2 | 3 | 3 | 28 | |
| MARRJA E RYSHFETIT | 30 | 6 | 36 | 57 | 1 | 3 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 6 | 9 | 30 | 48 | |
| DHËNIA E RYSHFETIT | 6 | 6 | 12 | 18 | 1 | 4 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 7 | 11 | 5 | 7 | |
| DHËNIA E RYSHFETIT ZYRTARIT PUBLIK TË HUAJ | 2 | 0 | 2 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | |
| USHTRIMI I NDIKIMIT | 3 | 2 | 5 | 9 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 | 9 | |
| NXJERRJA E KUNDËRLIGJSHME E VENDIMEVE GJYQËSORE | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| ZBULIMI I FSHEHTËSISË ZYRTARE | 6 | 0 | 6 | 18 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 6 | 18 | |
| FALSIFIKIMI I DOKUMENTIT ZYRTAR | 5 | 9 | 14 | 18 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 1 | 13 | 17 | |
| ARKËTIMI DHE PAGESA E KUNDËRLIGJSHME | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| PËRVETËSIMI I KUNDËRLIGJSHËM I PASURISË ME RASTIN E BASTISJES APO EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT GJYQËSOR | 2 | 0 | 2 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 3 | |
| MOSRAPORTIMI OSE RAPORTIMI I RREMË I PASURISË, I TË ARDHURAVE, I DHURATAVE, I DOBISË TJETËR MATERIALE OSE DETYRIMEVE FINANCIARE | 1 | 0 | 1 | 4 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 4 | |

